



BASHKIA
TIRANË

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Gjiguria” shpk

Adresa: Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Ibrahim Rugova, Prane Gardes se Republikes, Pallati Kontakt, mbi Union Bank, Tirane

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Sistemimi i Përroit të Kallmit”.

Numri i referencës së procedurës: REF-59479-06-01-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: **“Sistemimi i Përroit të Kallmit”.**

Fondi limit: 65,642,375 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e gjashtëqind e dyzet e dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 3 (tre) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 29.06.2020, ora 11:00.

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 34 datë 08.06.2020.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Shkelqimi 07” shpk

NUIS K68121808W

Vlera e ofertës = **41,000,000 (dyzet e një milionë) lekë pa TVSH.**

2. Operatori ekonomik “Gjiguria” shpk

NUIS J62903456H

Vlera e ofertës = **45,971,052 (dyzetë e pesë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.**

3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Viante Konstruksion” shpk & ”Euro Alb” shpk

NUIS

K47103804L

NUIS

K66613407H

Vlera e ofertës = **47,286,596** (dyzetë e shtatë milion e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Llazo” shpk & “Meteo” shpk

NUIS

K24218401K

NUIS

L26310801C

Vlera e ofertës = **49,583,202** (dyzetë e nëntë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind e dy) lekë pa TVSH.

5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kevin Konstruksion” & “Pepa Group” shpk

NUIS

K71401004W

NUIS

L42215009L

Vlera e ofertës = **50,075,930** (pesëdhjetë milionë e shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH.

6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “KMK” shpk & “Boshnjaku.B” shpk & “2N” shpk & “Shijaku” shpk

NUIS

L78223801E

NUIS

K72627402H

NUIS

L31615017C

NUIS J64102272V

Vlera e ofertës = **51,267,839** (pesëdhjetë e një milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

7. Operatori ekonomik “Salillari” shpk

NUIS

J62903125G

Vlera e ofertës = **51,950,890.80** (pesëdhjetë e një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë pikë tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

8. Bashkimi I Operatorëve ekonomikë “Dajti Park 2007” shpk & ”Senka” shpk

NUIS K11507003S

NUIS J94808405Q

Vlera e ofertës = **52,486,056** (pesëdhjetë e dy milionë e katëriqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

9. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Arb&Trans 2010” shpk & “Everest” shpk & “Ina” shpk

NUIS

L02325001T

NUIS J78311921L
NUIS

J61814009W

Vlera e ofertës = **53,430,226.92** (pesëdhjetë e tre milionë e katërqind e tridhjetë mijë e dyqind e njëzet e gjashtë pikë nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

10. Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk

NUIS J62028009B

Vlera e ofertës = **53,819,243** (pesëdhjetë e tre milionë e tetëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH.

11. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “SMO Union” shpk & ”Curri” shpk

NUIS

J66902042Q

NUIS

J67902718S

Vlera e ofertës = **54,883,801** (pesëdhjetë e katër milionë e tetëqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e një) lekë pa TVSH.

12. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Besta” shpk & “Fled” shpk

NUIS J62903182B

NUIS K17621104C

Vlera e ofertës = **55,015,597** (pesëdhjetë e pesë milionë e pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë)lekë pa TVSH

13. Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk

NUIS J68310708M

Vlera e ofertës = **56,088,966** (pesëdhjetë e gjashtë milionë e tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë)lekë pa TVSH

14. Operatori ekonomik “BE-IS” shpk

NUIS

K71412003A

Vlera e ofertës = **57,886,591** (pesëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e një)lekë pa TVSH

15. Operatori ekonomik “Bami” shpk

NUIS J94416206R

Vlera e ofertës = **58,811,361.10** (pesëdhjetë e tetë milionë e tetëqind e njëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një pikë dhjetë) lekë pa TVSH

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Shkelqimi 07” shpk

K68121808W

- Listpagesat e paraqitura nga Shoqëria “Shkëlqimi 07” shpk për periudhën Qershor 2019-Maj 2020 nuk janë të shoqëruara me FDP, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 4, gërma “b”.
- Referuar Shtojcës 10 si dhe dokumentacionit të paraqitur mbi disponimin e mjeteve rezulton se Shoqëria “Shkëlqimi 07” shpk nuk disponon Kamion vetshkarkues 7-10 Ton, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12, ku ndër të tjera parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 7-10 Ton”*.
- Gjithashtu, pas verifikimit të dokumentacionit për mjetin Kamionçinë 3.5-5 Ton, rezulton se: kamionçina me targë AA 609 DA ka kapacitet mbajtës 3.9 Ton; mjeti me targë AA 481 YJ ka kapacitet mbajtës 2.3 Ton; mjeti me targa AA 490 YJ ka kapacitet mbajtës 2.2 Ton; kamionçina me targë AA 611 DA ka kapacitet mbajtës 0.9 Ton ndërsa mjeti me targa AA 783 YJ ka kapacitet mbajtës 0.8 Ton. Vetëm mjeti me targa AA 609 DA plotëson tonazhin e kërkuar sipas DST. Për kamionçinat e tjera te deklaruar në Shtojcën 10, Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbi disponimin e tyre. Për sa më lart, Operatori ekonomik, nuk plotëson DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12, ku ndër të tjera parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) Kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5-5 Ton”*.
- Referuar Shtojcës 10, Shoqëria “Shkëlqimi 07” shpk ka deklaruar se disponon 3 (tre) Autobot uji përkatësisht me targa AA 206 KP; AFR 615 si dhe VL 6207 B. Për mjetet me targa AFR 615 si dhe VL 6207 B, Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbi disponimin e tyre; ndërsa mjeti me targa AA 206 KP rezulton Autobot nafte, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12, ku ndër të tjera parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Autobot Uji”*.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

2.Oferta e paraqitur nga Bashkimi i operatorëve ekonomikë “KMK” shpk & “Boshnjaku.B” shpk & “2N” shpk & “Shijaku” shpk

NUIS

L78223801E

NUIS

K72627402H

NUIS

L31615017C

NUIS J64102272V

- Operatori Ekonomik “Shijaku” shpk nuk ka paraqitur dokumentin “Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar “ per bilancet e tre viteve te fundit, çka bie ne kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 1.
- Operatori Ekonomik “Shijaku” shpk nuk ka paraqitur *“Vërtetimin që konfirmon*

shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri” cka bie ne kundershtim me DST, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, germa g).

- Operatori Ekonomik “Shijaku” shpk nuk ka paraqitur “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019...” cka bie ne kundershtim me DST, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, kapacitetin ekonomik dhe financiar, pika 3.
- Bashkimi i Operatoreve ekonomik nuk plotëson pikën 8 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “*Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, diplome/deshmi përkatëse leshuar nga institucione te akredituara nga autoritetet pergjegjese shteterore, dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve), si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë ...” pasi nuk janë paraqitur diplome/deshmi përkatëse leshuar nga institucione te akredituara nga autoritetet pergjegjese shteterore për punonjësit hidraulik.*
- Operatori Ekonomik “Shijaku” shpk nuk ka paraqitur “*Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9*”, per vleresimin e përvojës së suksesshme cka bie ne kundershtim me DST, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, germa dh).
- Operatori Ekonomik K.M.K nuk paraqitur deklaratën e kerkuar: “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar sipas shtojcës 10 nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tirane*”, cka bie ne kundershtim me DST, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12, germa g).
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë ka deklaruar 2 (dy) kamion me kapacitet mbajtës 7-10 ton, përkatësisht me targa AA918YI, i cili rezulton me kapacitet mbajtes 2.4 ton, pra rezulton nen tonazhin e kerkuar dhe kamioni me targa AA265EM me kapacitet mbajtës 9.1 Ton, (cili rezulton I marrë me qira dhe është paraqitur certifikatë për transport mallrash “për llogari të vet”, për pasojë ky mjet nuk mund të jepet me qira. Per sa me lart, B.O nuk ka paraqitur dokumentacion te rregullt per asnjërin nga mjetet e deklaruar, cka bie ne kundershtim me DST, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12, ku nder te tjera percaktohet se: Operatori ekonomik pjesmarres duhet te disponoje 2 (dy) kamiona me kapacitet mbajtes 7-10 Ton.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë ka deklaruar 4 (kater) kamion me kapacitet mbajtës 10-20 ton, përkatësisht me targa KR7395A, i cili rezulton me kapacitet mbajtes 6.3 ton, pra rezulton nen tonazhin e kerkuar, mjeti me targa AA467PE, i cili rezulton me kapacitet mbajtes 3.1 ton, pra rezulton nen tonazhin e kerkuar, mjeti me targa AA4131G, i cili rezulton me kapacitet mbajtes 6.2 ton, pra rezulton nen tonazhin e kerkuar dhe kamioni me targa AA265EM me kapacitet mbajtës 9.1 Ton, (cili rezulton i marrë me qira dhe është paraqitur certifikatë për transport mallrash “për llogari të vet”, për pasojë ky mjet nuk mund të jepet me qira, si dhe eshte nen

kapacitetin e kerkuar), cka bie ne kundershtim me DST, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12 , ku nder te tjera percaktohet se: Operatori ekonomik pjesmarres duhet te disponoje 2 (dy) kamiona me kapacitet mbajtes 10-20 Ton.

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë ka deklaruar 6 (gjashtë) kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton, përkatësisht me targa AA136XO, e cila rezulton me kapacitet mbajtes 1.1 ton, pra eshte nen tonazhin e kerkuar, si dhe i mungon *Çertifikatë për transport mallrash brenda vendit(e vlefshme)*, mjeti me targa AA133PB, i cili rezulton me kapacitet mbajtes 1.1 ton, pra eshte nen tonazhin e kerkuar, si dhe i mungon *Çertifikatë për transport mallrash brenda vendit(e vlefshme)*, mjeti me targa AA463HR, i cili rezulton me kapacitet mbajtes 1.3 ton, pra rezulton nen tonazhin e kerkuar, mjeti me targa AA14IO, i cili rezulton me kapacitet mbajtes 1.1 ton, pra rezulton nen tonazhin e kerkuar, mjeti me targa AA467PE, i cili rezulton me kapacitet mbajtes 3.1 ton, pra rezulton nen tonazhin e kerkuar dhe mjeti me targa AA708RI me kapacitet mbajtës 1.3 Ton, pra rezulton nen tonazhin e kerkuar, cka bie ne kundershtim me DST, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12 , ku nder te tjera percaktohet se: Operatori ekonomik pjesmarres duhet te disponoje 2 (dy) kamionçina me kapacitet mbajtes 3.5-5 Ton.
- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik ka deklaruar 4 (kater) Autobot Uji, konkretisht Mjeti me targë AA149ZO rezulton mjet i montuar, kamion+ depozitet uji, mjeti me targë AA173PO rezulton mjet i montuar, kamion+ depozitet uji, per mjetin me targa DR4633E nuk eshte paraqitur dokumentacioni i kerkuar, konkretisht çertifikate e kontrollit teknik; siguracion mjeti, (i vlefshëm); çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme), si dhe per mjetin me targa AA902IR nuk eshte paraqitur dokumentacioni i kerkuar, konkretisht çertifikate e kontrollit teknik; siguracion mjeti, (i vlefshëm); çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme), cka bie ne kundershtim me DST, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12, ku nder te tjera percaktohet se: Operatori ekonomik pjesmarres duhet te disponoje 1 (një) Autobot Uji.

3. Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Arb&Trans 2010” shpk & “Everest” shpk & Ina” shpk

L02325001T

NUIS

NUIS J78311921L

NUIS

J61814009W

- Çertifikata ISO 39001-2012 e paraqitur nga Shoqëria “Everest” shpk ka skaduar, pasi afati i vlefshmërisë së saj ka përfunduar më datë 11.06.2020, ndërkohë që procedura e prokurimit është zhvilluar më datë 02.07.2020. Për sa më lart, Shoqëria “Everest” shpk nuk plotëson DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 11, gërma “d”.
- Referuar Shtojcës 10, Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon 3 (tre) Kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5-5 Ton përkatësisht me targa: AA 375 NB (e cila ka dokumentacion të rregullt), mjeti me targa AA 126 MX (për të cilin nuk

është paraqitur Akti i Pronësisë ashtu siç parashikohet në DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12, gërma “b”); si dhe mjeti me targa AA 451 XY (i cili nuk plotëson tonazhin e kërkuar sipas DST, pasi ka kapacitet mbajtës 5.8 Ton). Për sa më lart, Bashkimi i Operatorëve ekonomik disponon vetëm 1 (një) mjet Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5-5 Ton, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 2 (dy) Kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5-5 Ton”*.

- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Everest” shpk & “Arb&Trans-2010” shpk & “Ina” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

4. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk

NUIS

J62028009B

- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) Kamionçina përkatësisht: mjeti me targa TR 3573 I (me kapacitet mbajtës 4.1 Ton) si dhe mjeti me targa TR 0098 K (me kapacitet mbajtës 3.4 Ton). Vetëm mjeti me targa TR 3573 I plotëson tonazhin e kërkuar sipas DST. Për sa më lart, Operatori ekonomik, nuk plotëson DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12, ku ndër të tjera parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) Kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5-5 Ton”*.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

5. Oferta e paraqitur nga operatoro ekonomik “Sterkaj”shpk

NUIS J68310708M

- Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk nuk plotëson pikën 12 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10)”* pasi nga 2 kamionë të kërkuar me këtë kapacitet është deklaruar dhe paraqitur dokumention vetëm për një.

- Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk nuk plotëson pikën 12 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10)”* pasi nga 2 kamionë të kërkuar me këtë kapacitet është deklaruar dh dorëzuar dokumentacion vetëm për 1. Konkretisht mjete me targë AFR678, I cili rezulton mbi kapacitimin e kërkuar, 29.58 ton.
- Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk nuk plotëson pikën 12 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10)”* pasi mjete autovinc me targë AA997HM i marrë me qera rezulton me Çertifikatë për transport mallrash vetëm për llogari të vet dhe jo për të tretë.
- Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk nuk plotëson pikën 12 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10)”* pasi mjete kamioncinë me targë AA079ZL i marrë me qera rezulton me Çertifikatë për transport mallrash vetëm për llogari të vet dhe jo për të tretë.
- Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk nuk plotëson gërmën “h” të pikës 12 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor”* pasi nuk është paraqitur deklaratë pr vendndodhjene e mjeteve.
- Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk nuk plotëson pikën 12 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10)/fadromë/cope 2”* pasi nga 2 fadroma të kërkuar është deklaruar vetëm një.
- Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk nuk plotëson pikën 12 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10)/fadromë/cope 2”* pasi eskavatori me goma është eklaruar dhe paraqitur vetëm me faturë zhdoganimi pa dokumentacionin e kërkuar.
- Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk nuk plotëson pikën 12 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10)/fadromë/cope 2”* pasi në Shtojcën 10 nuk ka deklaruar mjetin e kërkuar Autobot Uji.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Gjiguria” shpk**, me adresë: **Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Ibrahim Rugova, Prane Gardes se Republikes, Pallati Kontakt, mbi Union Bank, Tirane**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **45,971,052 (dyzetë e pesë milionë e nëntqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëdhjetë e dy) lekë** pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2,

Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **47,286,596 (dyzetë e shtatë milion e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë)** lekë pa TVSH siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 17.07.2020

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, është paraqitur Formulari i Ankesës nga bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Viante Konstruksion” shpk & “Euro Alb” shpk, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën Nr. 25138 Prot. datë 27.07.2020 (administruar në dosjen e prokurimit) në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: **“Sistemimi i Përroit të Kallmit”**.

Me marrjen e ankesës nga Operatori ekonomik i mësipërm në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) me Urdhërin me Nr. 16851/3 Prot. dt. 27.07.2020 është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni i prokurimit publik. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma ”a” të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) me Urdhërin me 16851/4 Prot. dt. 27.07.2020 u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave, i cili pasi u njoh me pretendimet e bashkimit të Operatorëve ekonomikë “Viante Konstruksion” shpk & “Euro Alb” shpk konkludoi në mospranimin e ankesës, duke i kthyer përgjigje me shkresën me Nr. 25138/2 Prot. , datë 03.08.2020, (administruar në dosjen e prokurimit).